



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Raport i posaçëm për gjendjet në Qendrën e pranimit për të huaj në Gazi Babë

Konform Ligjit për avokatin e popullit („Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 60/03, 114/2009, 181/2016 dhe 189/2016), përveç kompetencave të tjera, Avokati i popullit ka kompetenca të monitorojë se a respektohen dhe mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat është kufizuar liria e lëvizjes.

Avokati i popullit si Mekanizëm parandalues nacional ka mandat të përcaktuar me Protokollin fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, jonjerëzor ose nënçmues, i cili i mundëson kryerjen e vizitave në vendet e privimit nga liria dhe vendet e mbajtjes dhe përmes këqyrjes në kushtet materiale dhe trajtimin, t'i identifikojë rreziqet me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojit tjetër të veprimeve brutale dhe jonjerëzore dhe ndëshkuese.

Si në vitin e kaluar, edhe gjatë vitit 2017, ekipi i Mekanizmit parandalues nacional vazhdoi me vizitat dhe monitorimin në Qendrat transitore për pranim Vinojug dhe Tabanoc, si dhe në Qendrën e pranimit për të huaj në Gazi Babë dhe Qendrën për pranimin e azilkërkuesve në Vizbeg.

Qëllimi i vizitave të kryera ishte të bëhet inspektim në kushtet materiale dhe kapacitetet strehuese në të cilat vendosen refugjatët/emigrantët dhe të bëhen përpjekje drejt përmirësimit të sistemit për ndihmë juridike të personave refugjatë dhe realizimin pa pengesë të të drejtave të tyre të garantuara.

Gjatë vitit 2017, duke marrë parasysh intesitetin e zvogëluar të lëvizjeve të refugjatëve/emigrantëve nëpër „Rutën ballkanike“, në suaza të mandatit të tij dhe kompetencave të Mekanizmit parandalues nacional realizoi 6 vizita të paparalajmëruara në Qendrën e pranimi të azilkërkuesve në Gazi Babë (më datën: 07.03; 04.04; 28.10; 21.11; 22.11 dhe 26.12.2017).

❖ *Vërejtje hyrëse*

Qendra për pranimin e azilkërkuesve akoma funksionon në objekt në Gazi Babë i cili fillimisht ka qenë i dedikuar për strehimin e fëmijëve të moshës më të vogël (kopsht i fëmijëve). Mekanizmi parandalues nacional disa herë thekson se ky objekt sa i përket infrastrukturës nuk i plotëson standardet për mbajtjen e personave, ndërkaq edhe përskaaj paralajmërimeve se në vitin 2017 do të fillohet me ndërtimin e objektit ¹, të ri, i njëjti nuk u realizua. Gjatë vitit të kaluar u ndërmorrën më shumë aktivitete ndërtimore në drejtim të përmirësimit të kushteve për vendosje në Qendër, mirëpo kjo megjithatë nuk e përjashton nevojën e dislokimit të Qendrës në objekt tjetër përkatës.

Sa i përket trajtimit dhe shkallës së respektimit të të drejtave të personave të mbajtur në Qendër, ekipi i Mekanizmit parandalues nacional edhe pse konstatoi disa përmirësime, megjithatë mbeten konstatimet e përgjithshme se në Qendër vazhdon praktika që personat të mbahen me aktvendime të paligjshme të miratuara nga Ministria e punëve të brendshme.

Mekanizmi parandalues nacional shpreh brengosje serioze edhe për shkak të pengimit të mandatit të tij gjatë një vizite, kur zyrtarët qëllimisht dhanë informata të pavërteta për numrin e personave të vendosur në Qendër, njëkohësisht duke bërë përpjekje që disa prej tyre edhe t'i fshehin.

Në tekstin që vijon do të bëhet fjalë më shumë për kushtet materiale në kapacitetet strehuese, trajtimin dhe shkallën e respektimit të të drejtave të personave të mbajtur.

¹ Përgjigja e MPB BSP Seksioni për punë kufitare dhe migracion regj. nr. 22.5-73304/2 të datës 22.12.2016 të Raportit të posaçëm të AP-MPN të datës 08.11.2016.

❖ *Kushtet materiale*

Kushtet materiale në kapacitetet strehuese të Qendrës shënojnë përmirësim të vazhdueshëm. Gjegjësisht, gjatë kohës së vizitave të realizuara ekipi i Mekanizmit parandalues nacional konstatoi se kohë pas kohe ndërmerren aktivitete ndërtimore për rinovimin e hapësirave për vendosje dhe gjithashtu si rezultat i donacioneve nga më shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare Qendra është pajisur në mënyrë përkatëse me aparate të kuzhinës dhe aparate të tjera të teknikës së bardhë.

Në këtë kuptim, ekipi i Mekanizmit parandalues nacional gjatë kohës së vizitës së fundit (26.12.2017) konstatoi se zhvilloheshin aktivitete ndërtimore që kishin për qëllim përshtatjen e një hapësire-karantin, në të cilën do të vendoseshin emigrantët para se të kontrollohen të njëjtit nga mjeku, dhe pas kësaj do të shpërndareshin në ndonjërin nga hapësirat e tjera për vendosje. Gjithashtu në pjesën e cila është dedikuar për vendosjen e personave të gjinisë femrore njëra nga hapësirat është përshtatur për qëndrim ditor, ndërkaq gjatë kohës së vizitës kishte një kuzhinë të re të vendosur, tryezë me karrige, televizor, si dhe një divan për ulje. Dritaret janë ndërruar në shumicën e hapësirave, ndërkaq është planifikuar që sërish të ngjyrosen muret në hapësirat (gjatë vizitave shumica e mureve janë shkruar me mesazhe nga personat që ishin vendosur aty, nga të cilat mund të vërehet se disa persona janë mbajtur më shumë se një muaj). Përveç kësaj, u informuam se janë porositur edhe kondicionerë me inverter të cilët do të vendosen në hapësirat për strehim.

Dhomat në pjesën e cila është dedikuar për vendosjen e personave të gjinisë femrore janë pajisur me krevate të hekurta në dy nivele, dyshek të ri dhe shtretër, si dhe tryezë me karrige. Në pjesën ku vendosen personat e gjinisë mashkullore qasja deri te shumica e dhomave është mbyllur për shkak të numrit të vogël të personave të cilët kohëve të fundit vendosen në Qendër. Edhepse ato hapësira ishin të rinovuara kah fundi i vitit 2016, megjithatë vëreheshin dëmtime të inventarit. Gjatë bisedave me zyrtarët ishte theksuar se në disa raste kur ka pasur më shumë persona të ndalur në Qendër, ka ndodhur që disa prej tyre duke thyer xhamin e dyerve kanë provuar të ikin prej Qendrës.

Gjatë kohës së vizitës së fundit nga një seri vizitash të realizuara në vitin 2017, të gjithë personat ishin vendosur në një hapësirë, e cila gjendet menjëherë pranë zyrës kujdestare. Kjo hapësirë është e gjërë dhe pajisur me 9 krevate me nivele. Hapësira është pajisur me trupa ngohës, por përveç tyre, personave u ishte lënë në dispozicion edhe një panel-ngrohës. Temperatura e matur më datën 26.12.2017 ishte 23oC ndërsa lagështia e ajrit ishte 41,4 RH %. Në hapësirë ka një televizor dhe një frigorifer, ndërsa në korridor para dhomës ka një kuzhinë të improvizuar, në të cilën personat shpesh dijnë të gatujnë diçka. Ekipi i Mekanizmit parandalues nacional vërejti se edhe përkaj rinovimit të bërë në tualetët kah fundi i vitit 2016, një pjesë e sanitareve tanimë janë të dëmtuara.

Përmirësimi i kushteve në kapacitetet strehuese, siç është theksuar edhe më lartë në tekstin, nuk e përjashton mospërshtatjen e infrastrukturës së një objekti me qëllimin për të cilin përdoret - Qendër për pranimin dhe mbajtjen e personave-të huaj. Më shumë në favor të kësaj flet fakti që zyrtarët policor edhe përkaj faktit që nuk janë me numër të mjaftueshëm, në kushte kur do të duhej të mbajnë një numër më të madh të personave, të njëjtit medoemos duhet t'i vendosin në hapësira të cilat fare nuk do të kishin mundësi vazhdimisht t'i mbikëqyrin, përkatësisht hapësira të cilat janë larg prej zyrës kujdestare, që vetvetiu rrit rrezikun nga incidentet e padëshiruara (si psh. raste të vetlëndimit, pamundësisë për intervenim në raste urgjente, parandalimin e incidenteve ndërmjet personave të mbajtur etj).

❖ *Trajtimi*

Nga bisedat e realizuara me personat e mbajtur në Qendër, ekipi i Mekanizmit parandalues nacional konstatoj përmirësim lidhur me trajtimin ndaj tyre nga ana e zyrtarëve, duke marrë parasysh se asnjëri nga personat me të cilët u realizua bisedë nuk u ankua për ndonjë maltretim (fizik ose psikik) ose sjellje nga zyrtarët. Megjithatë, njëra nga ankesat kryesore të personave të mbajtur është mungesa e informatave lidhur me kohëzgjatjen e ndalimit të tyre, ndërsa disa prej tyre theksuan edhe se fare nuk janë të njoftuar me arsyet për mbajtje. Gjithashtu të gjithë ankohen se nuk kanë mundësi të shetisin në ajër të pastër jashtë nga hapësirat e Qendrës edhe përkaj faktit që disa prej

tyre mbahen edhe më shumë se 25 ditë. E gjithë kjo ndikon ndaj gjendjes psikike të emigrantëve në drejtim të zhvillimit të deprivacioneve të ndryshme. Disa nga emigrantët me të cilët u bisedua theksuan „si kalon koha memzi mbahen që të mos bëjnë ndonjë budallallëk". Në këtë kuptim, nga bisedat me personat zyrtar morrëm vesh se në të kaluarën më të shpeshta kanë qenë rastet e vetëlëndimit, ndërkaq ka pasur edhe raste kur ndonjë person i mbajtur është orvatur të vetvritet, përkatësisht të varet. Personat e mbajtur me të cilët u bisedua theksuan se në Qendër fare nuk kanë biseduar me punonjës social pavarësisht faktit që zyrtarët theksuan se punonjësi social në Qendër bisedon me personat e mbajtur.

Mbrojtja shëndetësore për personat e mbajtur në Qendër fillimisht sigurohet përmes mjekut të angazhuar nga ana e Kryqit të kuq të RM-së, i cili është i pranishëm në Qendër tre herë në ditë dhe sipas nevojës, sidomos në rastet kur mbahen emigrantë të ri. Nga bisedat me personat e mbajtur, ekipi i MPN-së konstatoi se pas arritjes në Qendër janë kontrolluar nga ana e mjekut brenda ditës së parë dhe të dytë. Ata janë njoftuar për ditët kur është i pranishëm mjeku në Qendër, dhe raportin e tij ndaj tyre e vlerësuan si korrekt. Personat e mbajtur, gjithashtu theksuan se kontrollet në ordinancën e mjekut kryhen pa praninë e zyrtarëve të Qendrës, përkatësisht pjesëtarëve të policisë.

Sa i përket të ushqyerit, ekipi i MPN-së vuri re disa përmirësime. Personave u jepen pemë dhe perime të freskëta, si dhe produkte ushqimore për të gatuar ushqim në kuzhinë. Megjithatë edhemëtej mbetet vërejtja se në ushqimet që u jepen ka mungesë të ushqimit të ngrohtë dhe të gatuar.

❖ *Shkalla e realizimit dhe respektimit të të drejtave të personave të mbajtur*

- *Bazat e mbajtjes*

Ekipi i MPN-së bazën për ndalimin e personave e përcaktoi përmes inspektimit në aktvendimet për mbajtje, gjatë kohës së vizitave. Nga inspektimi i kryer me padryshim del se edhemëtej njëri nga problemet më serioze mbetet mbajtja e paligjshme e personave

në Qendër. Gjegjësisht, edhe pse me intensitet të zvogëluar, akoma vazhdon praktika e mbajtjes së personave në Qendër me aktvendime të MPB-së me qëllim të përcaktimit të identitetit.

Nëse merret parasysh se për sjelljen e aktvendimit për mbajtje ka kompetencë vetëm gjykata kompetente, atëherë pa dyshim del se Ministria për punë të brendshme vazhdon me praktikën e miratimit të aktvendimeve të paligjshme për mbajtjen e personave në Qendrën e pranimi për të huaj.

Për dallim të bazës juridike të cekur në aktvendimet për mbajtje, ekipi i MPN-së nga të gjitha bisedat e realizuara, konkludoi se arsyeja faktike për të cilën personat mbahen në Qendrën e pranimi është për t'i siguruar ato si dëshmitarë në procedurat gjyqësore që udhëhiqen kundër palëve të treta. Vazhdimi i kësaj praktike është lëndë e kritikës së vazhdueshme nga ekipi i MPN-së në raportet e tij dhe në rekomandimet e adresuara drejtpërsëdrejti pranë autoriteteve kompetente.

- ***E drejta e personave të mbajtur të njoftohen në gjuhën në të cilën e kuptojnë për arsyet e privimit nga liria dhe mbajtja, si dhe për kohëzgjatjen e mbajtjes***

Ekipi i MPN-së konstatoi se personave të mbajtur u janë dhënë kopje nga Aktvendimet për ndalesë, të cilët faktikisht paraqesin formular të plotësuar në gjuhën maqedonase dhe angleze. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që shumica e personave të mbajtur nuk kuptojnë gjuhën angleze, madje nuk sigurohet as përkthyes në gjuhën të cilën e kuptojnë, ata metëvërtetë nuk janë të njoftuar për arsyet e privimit të tyre nga liria dhe mbajtjes në Qendër.

Disave nga personat të cilët e kuptojnë pak gjuhën angleze u është thënë se janë mbajtur në Qendër për shkak të nevojës për të dëshmuar ata para gjykatave kundër personave të tretë, njëherazi këta persona shfrytëzohen edhe si „përkthyes” për personat e tjerë në qoftë se flasin gjuhën e njëjtë (për shembull arabisht).

Personat e mbajtur me të cilët u bisedua theksuan se asnjëri nga zyrtarët e Qendrës nuk u ka dhënë informata se aktvendimet për ndaljen e tyre mund t'i ankimojnë.

Njëra nga ankesat kryesore të personave të mbajtur në Qendrën e pranimi është mungesa e informatave lidhur me kohëzgjatjen e ndalimit të tyre, ndërkaq një gjë e tillë nuk është theksuar as në Aktvendimet për mbajtje.

- ***E drejta e personave të mbajtur për qasje pranë avokatit***

Krahas zyrtarëve të Qendrës, sipas të cilëve çdo personit të mbajtur i sugjerohet për të drejtën për qasje pranë avokatit dhe se ka pasur raste ku disa prej tyre kanë angazhuar avokatë dhe kanë realizuar kontakte papengesa me të njëjtit, personat e mbajtur me të cilët u bisedua theksuan se fare nuk kanë qenë të informuar për mundësinë për të kërkuar ose kontaktuar me avokat.

Disa nga personat e mbajtur të cilët vet kanë pyetur për mundësinë për të angazhuar avokat janë këshilluar nga zyrtarët se nuk do të kenë nevojë për një gjë të tillë, përkatësisht se kundër tyre nuk udhëhiqet kurrfarë procedure dhe se pas dëshmimit të tyre para gjykatës do të lëshohen menjëherë.

- ***Qasje pranë procedurës për njohjen e të drejtës për azil***

Sipas zyrtarëve të Qendrës çdo person i mbajtur gjatë pranimi njoftohet me mundësinë për paraqitjen e kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, dhe se përfaqësuesit e Shoqatës maqedonase të juristëve të rinj për çdo javë kryejnë vizitë në Qendër dhe gjatë bisedave me personat e mbajtur u japin informata më të hollësishme lidhur me procedurën për njohjen e të drejtës për azil në Maqedoni.

Ekipi i MPN-së konstatoi se personat e mbajtur janë me të vërtetë të njoftuar me mundësinë për të paraqitur kërkesë për njohjen e të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë, por megjithatë mundësia për të shfrytëzuar këtë të drejtë u është dhënë vetëm pas dëshmimit të tyre para gjykatës përkatëse. Gjegjësisht, personat e mbajtur

janë faktikisht të penguar për të paraqitur kërkesë për njohjen e të drejtës për azil para se të japin deklaratë në procedurat gjyqësore të cilat udhëhiqen kundër personave të tretë.

Ekipi i MPN-së konstatoi se në realitet të gjithë personat e mbajtur pas dëshimit të tyre nënshkruajnë kërkesën për njohjen e të drejtës për azil, si një mënyrë e vetme që më shpejtë të lirohen, përkatësisht të transportohen në Qendrën e pranimi për azilkërkues ku mundën lirshëm të lëvizin dhe të dalin kur të duan. Numri më i madh i personave të mbajtur të cilët janë transportuar në Qendrën e pranimi për azilkërkues nuk janë njoftuar se dokumentet të cilat i kanë nënshkruar kanë qenë kërkesa për njohjen e të drejtës për azil, as që kanë pasur qëllim të paraqesin kërkesë të tillë. Atyre vetëm u është thënë se për t'i transportuar medoemos duhet t'i nënshkruajnë këto dokumente.

- ***E drejta e personave të mbajtur për të informuar personin e tretë për mbajtjen e tyre (e drejta për bisedë telefonike)***

Udhëheqësi i ndërrimit të Qendrës theksoi se të ndaluarve u mundësohet të realizojnë biseda telefonike dhe të njëjtat evidentohen në mënyrë përkatëse. Megjithatë, ka pasur raste ku për persona të caktuar të mbajtur që të mund të realizojnë bisedë telefonike është dashur paraprakisht të kërkojnë pëlqim nga zyrtarët e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim.

Nga bisedat me personat e mbajtur, ekipi i MPN-së konstatoi se njërit nga personat edhe pse i kishin lejuar të realizojë bisedë telefonike, ai kishte qenë praktikisht i penguar për shkak se nuk e kishin lejuar të bëjë inspektim në listën e emrave të celularit i cili paraprakisht i ishte konfiskuar. Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së reagoi pranë udhëheqësit të ndërrimit i cili theksoi se këto situata në të ardhmen nuk do të duheshte të paraqesin problem.

- ***E drejta e personave të mbajtur për t'u njoftuar me të drejtat dhe obligimet e tyre gjatë kohës së qëndrimit në Qendër***

Ekipi i Mekanizmit parandalues nacional gjatë inspektimit të kryer në dosjet individuale të personave të mbajtur konstatoi se në secilën prej tyre ekziston shënim zyrtar se personat janë të njoftuar me Rendin e shtëpisë, si dhe me të drejtat dhe detytrimet e tyre gjatë kohës së qëndrimit në Qendër.

Gjatë inspektimit të kryer në kapacitetet strehuese, ekipi i MPN-së gjithashtu konstatoi se në më shumë vende të dukshme janë theksuar rregullat e Rendit të shtëpisë në Qendër në gjuhën maqedonase, angleze dhe arabe. Megjithatë, për disa persona të cilët nuk i kuptojnë këto gjuhë nuk sigurohet përkthyes.

❖ Raste të konstatuara të trajtimit jo-adekuat

Gjatë kohës së një vizite në Qendrën e pranimit ekipi i MPN-së u ballafaqua me një tentim të zyrtarëve për të fshehur mbajtjen e 5 shtetasve të huaj dhe për të penguar mandatin e MPN-së.

Gjegjësisht, më datën 04.04.2017 gjatë realizimit të vizitës së paparalajmëruar, i cili konform metodologjisë së inkorporuar filloi bisedën me drejtorin e Qendrës, i njëjti u informua se gjatë kohës së vizitës në Qendër janë vendosur vetëm dy persona. Në evidencën zyrtare që udhëhiqet për personat e mbajtur në Qendër, gjithashtu ishte shënuar se, në atë moment janë mbajtur vetëm dy persona. Megjithatë, gjatë kohës së inspektimit në kapacitetet strehuese dhe hapësirat e tjera në Qendër, ekipi i MPN-së gjeti hapësira që ishin mbyllur me dry, për të cilat drejtori informoi se nuk përdoren gjatë kohës. Pas përpjekjeve për të lejuar hyrje në këto hapësira, ato u hapën dhe ekipi i MPN-së konstatoi se brenda gjenden pesë persona me prejardhje nga Siria. Nga biseda e realizuar me këta persona u konstatua se ata janë arrestuar dhe dërguar në Qendër në orët e hershme të mëngjesit po të njëjtën ditë. Të njëjtit fare nuk janë informuar për arsyet e privimit dhe mbajtjes së tyre, madje as nuk u janë dhënë këshilla për të drejtat e tyre. Pas vërejtjeve të dërguara pranë Drejtorit të Qendrës për veprimet në tërësi dhe trajtimin e këtyre personave, të njëjtit menjëherë janë liruar.

Për gjendjen e konstatuar lidhur me mbajtjen e personave jashtë procedurave të përcaktuara me ligj, për mosevidentimin e personave të mbajtur në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe për pengimin e mandatit të MPN-së përmes dhënies së informatave të pavërteta për numrin e personave të mbajtur dhe tentimin për fshehjen e tyre, MPN-ja e informoi publikun në briefing me gazetarë, njëherazi paraqiti edhe kërkesë pranë ministrit për punë të brendshme që të ndërmer masa urgjente për kontroll dhe rishqyrtim të punës së Qendrës dhe përcaktimin e përgjegjësisë së drejtorit, me qëllim që të ndalet mbajtja e personave në Qendrën e pranimi për të huaj.

Nga Ministria për punë të brendshme pranuar përgjigje në të cilën situata me shtetasit e mbajtur sirian në mënyrë të paligjshme arsyetohet me kinse mbajtjen e tyre për shkaqe humane, për t'u ofruar ndihmën e nevojshme derisa të organizohet transporti për në Qendrën transitore për pranimi Vinojug ku personat synonin të shkonin.

Ekipi i MPN-së gjatë njërës vizitë në Qendër hasi edhe një nënë të mbajtur me dy fëmijë të mitur. Duke marrë parasysh se MPN-ja në raportet e tij vazhdimisht rekomandon që mbajtja e shtetasve të huaj në këtë qendër të bëhet vetëm në situata të jashtëzakonshme, dhe e njëjta mos të përdoret fare për strehim të kategorive vulnerable të njerëzve, si në rastin konkret, menjëherë i shqyrtoi arsyet për mbajtje. Në këtë kuptim, ishte konstatuar se mbajtja e nënës me dy fëmijët e mitur në Qendrën e pranimi për të huaj është bërë vetëm për shkak të faktit që përfaqësuesit e Ministrisë për punë dhe politikë sociale (MPPS) nuk kanë pranuar që këta persona të vendosen në të ashtuquajturën „Shtëpi të sigurtë” për shkak se nuk kanë qenë azilkërkues. Pas intervenimit të MPN-së, nënës dhe fëmijëve të mitur u ishte mundësuar të paraqesin kërkesë për njohjen e të drejtës për azil në Qendër dhe të njëjtit janë transferuar në „Shtëpinë e sigurtë”. Megjithatë, ekipi i MPN-së shpreh brengosje për shkak të vendimit të MPPS-së që në „Shtëpinë e sigurtë” të vendosen vetëm kategori vulnerable të personave të cilët janë azilkërkues.

KONSTATIME:

1. Vazhdon praktika e mbajtjes së paligjshme të personave në Qendër me aktvendime të MPB-së me qëllim të identifikimit të identitetit;
2. MPN-ja ka identifikuar një rast të trajtimit joadekuat dhe mosregjistrimit të personave të mbajtur në evidencën zyrtare që e udhëheq Qendra;
3. Pengimin e mandatit të MPN-së duke dhënë informata të rreme për numrin e personave të mbajtur dhe përpjekje për t'i fshehur ato;
4. Personave të mbajtur në Qendër nuk u lejohe qasje në procedurën për njohjen e azilit në RM në momentin që shprehin synimin e tyre për ta bërë këtë;
5. Personat e mbajtur nuk lejohen të shetisin në ajër të pastër jashtë hapësirave të Qendrës edhe pse disa prej tyre mbahen edhe më shumë se 25 ditë;
6. Personave të mbajtur fare nuk u sigurohet mbështetje psiko-sociale edhe pse ndalimi ndikon mbi paraqitjen e deprimimeve të ndryshme tek të njëjtit;
7. Qendra e pranimi akoma funksionon në një objekt qëllimi fillestar i të cilit ka qenë vendosja e fëmijëve të moshës më të vogël (kopsht i fëmijëve), për çka MPN-ja shumë herë ka theksuar se infrastruktura nuk i plotëson standardet për mbajtjen e personave.

REKOMANDIME:

Drejtuar Qendrës pranuese për të huaj:

1. Të mos bëhet pranimi i personave me qëllim të mbajtjes në Qendër në bazë të Aktvendimeve të miratuara nga MPB-ja për përcaktimin e identitetit, sepse edhe në Rregulloren për rendin e shtëpisë së Qendrës së pranimi është theksuar se vendosja e një të huaji identiteti i të cilit nuk mund të përcaktohet kryhet në bazë të aktvendimit të gjykatës;
2. Çdo strehim i personave në Qendër, qoftë edhe për një afat të shkurtë kohor, medoemos duhet të regjistrohet dhe evidentohet në evidencën përkatëse të cilën e udhëheq Qendra;

3. Sipas kërkesës së ekipit të MPN-së, zyrtarët në çdo kohë të japin informata të sakta dhe me kohë për numrin e personave të mbajtur në Qendër.
4. Personave të mbajtur në Qendër t'u mundësohet qasje papengesë pranë procedurës për njohjen e të drejtës për azil, në momentin kur do të kërkojnë këtë;
5. Personave të mbajtur t'u sigurohet papengesë shfrytëzimi i të drejtës për shetitje, në mënyrë siç është parashikuar në Rregulloren për rendin e shtëpisë të Qendrës së pranimit.
6. Personave të mbajtur t'u sigurohet mbështetje psiko-sociale nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me një punonjës social që do të mbajë evidencën përkatëse për këtë.

Deri te Ministria për punë të brendshme:

1. Menjëherë të ndalet praktika e Ministrisë së punëve të brendshme me sjelljen e aktvendimeve për mbajtjen e personave në Qendrën e pranimit për të huaj me qëllim të përcaktimit të identitetit, për shkak se organ i vetëm kompetent i cili mund të urdhërojë ndalimin e të huajve në këtë bazë është gjykata kompetente.
2. Të ndërmarrin masa konkrete dhe aktivitete për shqyrtimin e ligjshmërisë së punës së Qendrës përmes kontrolleve të brendshme të cilat do të kenë për qëllim, ndërmjet tjerash, të hulumtojnë gjithashtu se a kryhet evidentimi në mënyrë përkatëse dhe me kohë i të gjithë personave që mbahen në Qendër.
3. Të ndërmerren masa konkrete dhe aktivitete për zhvendosjen sipas mundësive sa më të shpejtë të Qendrës në objekt tjetër përkatës.

AVOKATI I POPULLIT

Ixhet Memeti